

Të nderuar prindër, të nderuar persona me të drejtë kujdestarie (Erziehungsberechtigte),

Po ju drejtohem me një lutje dhe apel të pazakontë. Nuk është e nevojshme t'ju informoj për virusin korona (Covid-19), sepse mjetet tona të informimit publik ju njoftojnë vazhdimisht me hollësi lidhur me këtë çështje.

Vëmendja ime është përqëndruar sidomos te fëmijët dhe familjet tuaja. Kështu, nga njëra anë dua t'i mbroj nxënësit dhe nxënëset tona, nga ana tjetër kam dëshirë që të ruaj për ne të gjithë edhe pak nga jeta normale. Por që t'ia arrij kësaj kam nevojë për ndihmën dhe mbështetjen tuaj.

Qeveria federale ka ndërmarrë dje masa të ndryshme për të penguar përhapjen e virusit korona, të cilat prekin në radhë të parë shkollën. Këto masa vlejné sidomos për të mbrojtur ata që rrezikohen më tepër të sëmuren rëndë nga virusi korona. Mirëpo këto masa mund ta arrijnë ndikimin e tyre të plotë dhe të rezultojnë të suksesshme vetëm kur ne të gjithë të ndjekim të njëjtën strategji.

Deri në fillim të pushimeve të Pashkëve kam këto lutje në përputhje me moshën e fëmijës suaj:

- Nëse fëmija juaj është nxënës në shkollën fillore, në shkollën e mesme të tipit *Neue Mittelschule*, në klasat e ulta të gjimnazit ose në një shkollë për nxënës të veçantë (*Sonderschule*), ai nuk do të ketë mësim të rregullt prej të mërkurës, data 18 mars 2020, deri në fillim të pushimeve të Pashkëve. Po të keni mundësi, organizoni ju lutem, një njeri që të kujdeset në shtëpi për të. Nëqoftëse nuk keni mundësi që të organizoni një përkujdesje në shtëpi (veçanërisht kur punoni në fusha kritike, sidomos në shëndetësi, sigurim, tregtinë e sendeve ushqimore dhe infrastrukturën rrugore ose jeni një prind i vetëm), fëmija juaj mund të vazhdojë të shkojë në shkollë. Atje do të zhvillohen ushtrime dhe materiale për t'u thelluar në lëndët e ndryshme.
- Nëse fëmija juaj është nxënës në klasat e larta të gjimnazit, në një shkollë profesionale të lartë ose të mesme (p. sh. në një shkollë ekonomike të tipit *Handelschule* ose shkollë teknike e tipit *Fachschule*), në një shkollë profesionale ose politeknikum, ai nuk do të ketë mësim prej së hënës, data 16 mars 2020, deri në fillim të pushimeve të Pashkëve. Fëmija juaj duhet të përsërisë në shtëpi materialet mësimore të trajtuara sipas planit deri tani dhe të thellohet në to. Fëmijës suaj do t'i ofrohen përveç kësaj materiale të ndryshme mësimore, edhe në formë digjitale, nga shkolla. Është e mundur gjithashtu marrja direkt nga shkolla e këtyre ushtrimeve përsëritëse dhe thelluese, si dhe e materialeve të domosdoshme për to duke respektuar udhëzimet e rrepta higjienike.
- Mos lejoni në asnjë rast që për fëmijët tuaj të kujdesen gjyshet dhe gjyshërit (sidomos moshë më e rrezikuar është afërsisht ajo prej 65 vjeç e lart), sepse këta janë personat, të cilët duam t'i mbrojmë në mënyrën më të mirë.

Dua t'ju siguroj që fëmija juaj nuk do të humbasë asgjë nga mësimet, nëqoftëse nuk do të shkojë në shkollë: atje vetëm do të thellohet e përsëritet lënda e bërë deri tani.

Nëse keni pyetje të tjera, drejtojuni direkt shkollës suaj. Mësuesit vazhdojnë të jenë në vendin e tyre të punës duke u munduar që ta përballojnë së bashku me ne këtë situatë të jashtëzakonshme.

Duke reduktuar në mënyrë të ndërgjegjshme kontaktet sociale, ju ndihmoni në mënyrë të ndjeshme që njerëzit të mbesin të shëndetshëm në ambjentin e tyre privat.

Më besoni: edhe për mua nuk janë të lehta këto ndryshime të mëdha që kërkohen tani prej nesh. Unë jam baba dhe gjysh dhe e di se ç'duan të thonë ndryshime të tilla kaq të rënda për jetën e përditshme të një familje. Por jam i bindur se duhet ta bëjmë tani së bashku këtë hap të rëndësishëm për fëmijët dhe bashkëqytetarët tanë. Dua t'ju siguroj që ne, së bashku me landet dhe komunat, Seksionin e Arsimit (Bildungsdirektion) dhe të gjitha instancat në varësinë tonë, do të mundohemi me të gjitha forcat që t'u dalim zot sa më mirë që të jetë e mundur punëve në javët e ardhshme!

Pikat bazë të Rregullores kërkojini, ju lutem, në dekretin **Si duhet të sillet sistemi arsimor me virusin korona (Umgang des Bildungssystems mit dem Coronavirus)** në faqen e internetit www.bmbwf.gv.at/corona_info. Te ky link do të gjeni vazhdimisht edhe informacione aktuale për këtë temë.

Me urimet më të mira për ju dhe falemnderit për bashkëpunimin tuaj,

Heinz Faßmann